

VENDIM
Nr. 392, datë 27.6.2018

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 16.2.2017, PËR ÇËSHTJEN “HATIJA KUNDËR SHQIPËRISË” (KËRKESA NR. 53103/15)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 16.2.2017, për çështjen “Hatija kundër Shqipërisë” (kërkesa nr. 53103/15), në shumën 1 000 euro (një mijë euro), për kërkuesin, z. Shkëlqim Hatija, në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror, si dhe kostot e shpenzimet, duke e përjashtuar nga çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Vlera e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të konvertohet në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku depozitohet shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Vlera e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të kërkuesit, z. Shkëlqim Hatija, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet sipas vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 16.2.2017, për çështjen “Hatija kundër Shqipërisë”, kërkesa nr. 53103/15.

4. Pagimi i shumës së depozituar, sipas pikës 3 të këtij vendimi, në favor të kërkuesit, z. Shkëlqim Hatija, të bëhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë pas paraqitjes së dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda afatit 3-mujor nga data kur vendimi i Gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Për mospagim brenda afatit tremujor, të përmendur në pikën 4 të këtij vendimi, mbi shumën e mësipërme paguhen interesa të thjeshtë të barabartë me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

6. Efekti financiar, i parashikuar në pikat 1 e 5 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi